

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË LITUANISË**  
**DHE**  
**QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**  
**MBI RI PRANIMIN E PERSONAVE**  
**QË QËNDROJNË PA AUTORIZIM**

Qeveria e Republikës së Lituanisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës

Këtu e tutje të referuara si "Palët Kontraktuese".

*të vendosura që të forcojnë bashkëpunimin e tyre në mënyrë që të luftojnë imigrimin e paligjshëm në mënyrë më efektive.*

*duke dëshiruar që me anë të kësaj Marrëveshjeje dhe në bazë të reciprocitetit të krijojnë procedura të shpejta dhe efektive për identifikimin dhe kthimin e sigurt dhe të rregullt të personave të cilët nuk i kanë përmbushur, apo nuk përmbushin më tutje kushtet për hyrje ose qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Lituanisë ose Republikës së Kosovës dhe që në frymën e bashkëpunimit të lehtësojnë transitin e shtetasve të vendeve të treta apo të personave pa nënshtetësi.*

*duke qenë të vetëdijshëm për nevojën e lehtësimit reciprok të ri-pranimit dhe transitit të personave që hyjnë dhe qëndrojnë ilegalisht në territorin e vendit të tyre përkatës,*

Të udhëhequr nga detyrimet e tyre ndërkombëtare dhe legjislacioni në fuqi në territoret e shteteve të tyre përkatëse, duke iu referuar veçanërisht Konventës së datës 28 korrik të vitit 1951, e cila ka të bëjë me Statusin e Refugjatëve.

*janë dakorduar si në vijim:*

## Neni 1

### Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

(a) "Shtetas i Republikës së Kosovës " nënkupton çdo person që ka shtetësinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me legjislacionin në fuqi në territorin e Republikës së Kosovës;

(b) "Shtetas i Republikës së Lituanisë" nënkupton çdo person që ka shtetësinë e Republikës së Lituanisë, në pajtim me legjislacionin në fuqi në territorin e Republikës së Lituanisë;

(c) "Shtetas i një vendi të tretë" nënkupton çdo person që ka një shtetësi tjetër nga ajo e Palëve Kontraktuese;

(d) "Person pa shtetësi" nënkupton çdo person i cili nuk ka shtetësi të asnjë shteti;

(e) "Leje qëndrimi" nënkupton çdo lloj i lejeve të vlefshme të lëshuara nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese që i jep një personi të drejtën për të qëndruar në territorin e Palës Kontraktuese në fjalë. Kjo nuk përfshin lejen e përkohshme për të qëndruar në territorin e palës me qëllim të procedimit të një kërkesë për azil ose një kërkesë për leje qëndrimi;

(f) "Vizë" nënkupton lejen e lëshuar apo vendimin e marrë nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese që është e domosdoshme për hyrjen apo kalimin transit nëpër territorin e Palës përkatëse kontraktuese. Kjo nuk do të përfshijë vizat transite të aeroportit.

(g) "Shteti Kërkues" nënkupton Palën Kontraktuese që paraqet kërkesë për ri-pranim në pajtim me nenin 5 ose një kërkesë për kalim transit në pajtim me nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje; —

(h) "Shteti që i kërkohet" nënkupton Palën Kontraktuese të cilës në pajtim me nenin 5 të kësaj marrëveshjeje i adresohet kërkesa për ri-pranim, ose në pajtim me nenin 12 i adresohet kërkesa për transit;

(i) "Autoriteti kompetente" nënkupton çdo autoritet kombëtar të Palëve Kontraktuese të cilit i është besuar zbatimi i kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 17, paragrafi një (I) nën-paragrafi (a) të kësaj marrëveshjeje;

(j) “Transit” nënkupton kalimin e një shtetasi të vendit të tretë ose personi pa shtetësi në nëpër territorin e shtetit që i kërkohet, gjatë udhëtimit nga territori i Shtetit Kërkues për në vendin e destinacionit.

(k) “Të dhënat personale” nënkupton çdo informacion që ka të bëjë me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (subjekt i të dhënave); një person fizik i identifikueshëm është ai i cili mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi siç është emri, numri i identifikimit, të dhënat e vendndodhjes, një identifikues në internet ose një ose më shumë faktorë specifikë të identitetit fizik, fiziologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.

(l) “Përpunimi i të dhënave personale” nënkupton çdo veprim ose grup veprimesh që kryhet mbi të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, pavarësisht nëse bëhen ose jo me mjete të automatizuara, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, zbulimi me anë të transmetimit, shpërndarja ose përndryshe vënia në dispozicion, përafrimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi.

## **PJESA I**

### **OBLIGIMET E RIPRANIMIT**

#### **Neni 2**

#### **Ri-pranimi i shtetasve të Palëve Kontraktuese**

1. Shteti të cilit i kërkohet, me kërkesën nga shteti kërkues dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të përmendura në këtë Marrëveshje, do të ri-pranojë çdo person që nuk plotëson ose nuk plotëson më tej kushtet e zbatueshme për hyrjen apo qëndrimin e ligjshëm në territorin e Shtetit Kërkues, me kusht që të jetë dëshmuar ose mund të supozohet në mënyrë të vlefshme në bazë të dëshmive të siguruara *prima facie* se ata janë shtetas të shtetit që i kërkohet.



2. Shteti që i kërkohet gjithashtu do të ri-pranojë personat të cilëve u është privuar ose kanë hequr dorë nga shtetësia e shtetit që i kërkohet pas hyrjes në territorin e Shtetit Kërkues, përveç nëse personave të tillë të paktën u është premtuar natyralizimi nga autoritetet kompetente të Shtetit Kërkues.

3. Shteti të cilit i kërkohet, me kërkesë nga shteti kërkues pranon edhe të gjithë fëmijët e mitur të pamartuar të personit të cekur në paragrafin një (1), si dhe bashkëshortët, që kanë një shtetësi tjetër, të personit të cekur në paragrafin një (1), me kusht që ata kanë të drejtë hyrje dhe qëndrimi ose të marrin të drejtën për hyrje dhe qëndrim në territorin e palës që i kërkohet, përveç nëse ata kanë të drejtë të pavarur për qëndrimin në territorin sovran të shtetit kërkues.

4. Pasi Shteti që i kërkohet të ketë dhënë përgjigje pozitive me shkrim për kërkesën për ri-pranim, përfaqësuesi kompetent diplomatik ose konsullor i shtetit që i kërkohet, pavarësisht nga vullneti i personit që do të ri-pranohet dhe më së voni brenda tre (3) ditëve të punës, do të lëshojë dokumentin e nevojshëm të udhëtimit për kthimin e personit që do të ri-pranohet me një periudhë të vlefshmërisë prej tridhjetë (30) ditësh. Nëse, për arsye ligjore ose faktike, personi në fjalë nuk mund të transferohet brenda periudhës së vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit të lëshuar fillimisht, autoriteti përfaqësues kompetent diplomatik ose konsullor i të shtetit që i kërkohet pa vonesë por jo më voni se brenda tre (3) ditëve të punës do të lëshojë një dokument të ri të udhëtimit me një afat të vlefshmërisë me kohëzgjatje të njëjtë.

5. Në rast se autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës nuk ia lëshojnë dokumentin e udhëtimit personit që do të ri-pranohet brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga pranimi i përgjigjes pozitive në kërkesën për ri-pranim, konsiderohet se Pala Kontraktuese e Republikës së Kosovës e pranon dokumentin evropian të udhëtimit të lëshuar nga Republika e Lituanisë sipas Rregullores (BE) 2016/1953 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 26 tetor 2016 për krijimin e një dokumenti evropian të udhëtimit për kthimin e shtetasve të vendit të tretë me qëndrim ilegal dhe shfuqizim i Rekomandimit të Këshillit të datës 30 nëntor 1994 (në tekstin e mëtejme “Dokumenti evropian i udhëtimit”) do të përdoret për personin e caktuar që do të ri-pranohet.

6. Shteti që i kërkohet do të ri-pranojë personin edhe në rast se personi përveç shtetësisë së shtetit që i kërkohet ka edhe shtetësinë e një vendi të tretë.



### Neni 3

#### Ri-pranimi i shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi

1. Shteti që i kërkohet, me kërkesën për ri-pranim të paraqitur nga shteti kërkues dhe në përputhje me procedurën e parashikuar në këtë Marrëveshje, do të ri-pranojë të gjithë shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi të cilët nuk përmbushin, apo nuk përmbushin më tej kushtet e zbatueshme për hyrjen apo qëndrimin e ligjshëm në territorin e shtetit kërkues, me kusht që mund të dëshmohet ose mund të supozohet në mënyrë të vlefshme në bazë të dëshmive të ofruar *prima facie* se këta persona:

(a) Kanë ose në kohën e hyrjes së tyre kanë pasur një vizë ose leje qëndrimi të vlefshme të lëshuar Shteti që i kërkohet, ose

(b) Në mënyrë të paligjshme kanë hyrë në territorin e Shtetit Kërkues, duke ardhur drejtpërdrejtë nëpër rrugët ajrore nga territori i Shtetit që i kërkohet pasi kanë qëndruar ose kanë kaluar transit nëpër territorin e këtij të fundit.

2. Detyrimi për ri-pranim i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni nuk do të zbatohet nëse:

(a) Shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi ka qenë vetëm në transit ajror përmes një aeroporti ndërkombëtar të shtetit që i kërkohet, ose

(b) Shteti kërkues i ka lëshuar shtetasit të vendit të tretë ose personit pa shtetësi vizën apo lejen e qëndrimit para ose pas hyrjes në territorin e saj, përveç nëse:

(1) ai person ka një vizë apo leje të qëndrimit të lëshuar nga Shteti që i kërkohet, e cila skadon më vonë; ose

(2) viza ose leja e qëndrimit e lëshuar nga shteti kërkues është marrë duke shfrytëzuar dokumente të rrejshme apo të falsifikuara, ose duke bërë deklaratata të rrejshme, ose

(3) ai person nuk respekton asnjë nga kushtet e përcaktuara të vizës.

3. Republika e Kosovës në rast të një kërkesë për ri-pranim të dorëzuar nga ana e autoritetit kompetent të Republikës së Lituanisë, gjithashtu do të ri-pranojë ish-shtetas të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ish- shtetas të ish – Republikës Federative të Jugosllavisë të cilët nuk kanë marrë shtetësi tjetër dhe vendi lindjes apo vendi i përhershëm i qëndrimit të tyre në janar të vitit 1998 ka qenë në territorin të Republikës së

Kosovës, me kusht që ky fakt mund të konfirmohet nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës në datën e paraqitjes së aplikacionit për ri-pranim.

4. Pasi Shteti që i kërkohet të ketë dhënë përgjigje pozitive me shkrim në kërkesën për ri-pranim, shteti kërkues i lëshon personit të cilit i është pranuar ri-pranimi, dokumentin e udhëtimit të nevojshëm për kthimin e tij ose te saj.

5. Në rast se autoritete kompetente të Republikës së Kosovës nuk ia lëshojnë dokumentin e udhëtimit personit që do të ri-pranohet brenda 20 (njëzet) dite kalendarike nga marrja e përgjigjes pozitive në kërkesën për ri-pranim, konsiderohet se Pala Kontraktuese e Republikës së Kosovës pajtohet që dokumenti evropian i udhëtimit të lëshohet dhe të përdorët për ri-pranimin e personit të caktuar.

## **PJESA II**

### **PROCEDURA PËR RIPRANIM**

#### **Neni 4**

#### **Parimet**

1. Për çfarëdo transferimi të personit që do të ri-pranohet në bazë të njërit prej detyrimeve të përcaktuara në nenet 2 dhe 3 të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të rasteve të mbuluar në paragrafin 2 të këtij neni, kërkesa për ri-pranim duhet të dorëzohet tek autoriteti kompetent i shtetit që kërkohet.

2. Aplikacioni për ri-pranim nuk është i nevojshëm nëse personi i cili ri-pranohet posedon një dokument të vlefshëm udhëtimi, ose kur është e zbatueshme letërnjoftimin, vizën ose leje-qëndrimin e vlefshëm të shtetit që i kërkohet. Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën për datën, kohën dhe pikën e kalimit kufitar të ri-pranimit të personit përkatës dy (2) ditë pune para ri-pranimit të planifikuar.



## Neni 5

### Kërkesa për ri-pranim

1. Çdo kërkesë për ri-pranim duhet të përmbajë informatat në vijim:

(a) Të dhënat e veçanta të personit që do të ri-pranohet (p.sh. emri, mbiemri, emri i babait, data dhe vendi i lindjes dhe vendbanimi i fundit);

(b) Mjetet me të cilat do të ofrohen provat apo dëshmitë *prima facie* për shtetësinë, transitit, bazën për ri-pranim të shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi si dhe hyrjen dhe qëndrimin e paligjshëm;

(c) fotografinë dhe shenjat e gishtave të personit që do të ri-pranohet dhe të dhënat biometrike të personit, deri në masën që është e mundshme.

2. Për aq sa është e mundshme, kërkesa për ri-pranim duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:

(a) një deklaratë që tregon se personi që do të transferohet mund të ketë nevojë për ndihmë apo kujdes, me kusht që personi në fjalë të ketë pranuar shprehimisht deklaratën;

(b) çfarëdo mbrojtje tjetër, masa të sigurisë ose informatë në lidhje me shëndetin e personit e që mund të jenë të domosdoshme në rastin e veçantë të transferimit.

## Neni 6

### Mjetet e dëshmisë në lidhje me shtetësinë

1. Shtetësia në pajtim me paragrafin 1 të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje, mund të dëshmohet me anë të çfarëdo dokumenti të vlefshëm të renditur në listën e Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje. Nëse paraqitet ndonjë nga këto dokumentet, Palët Kontraktuese në mënyrë të ndërsjellë do të pranojnë shtetësinë pa pasur nevojë për hetime të mëtejme. Shtetësia nuk mund të dëshmohet përmes dokumenteve të falsifikuara.

2. Dëshmitë *prima facie* e shtetësisë në bazë të paragrafit 1 të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje, mund të sigurohet veçanërisht nëpërmjet dokumenteve të renditura në Shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje, edhe nëse perioda e vlefshmërisë së tyre ka skaduar. Nëse paraqiten dokumente të tilla, Palët Kontraktuese do të konsiderojnë se shtetësia është

përcaktuar, përveç nëse mund të dëshmohet e kundërta. Dëshmia *prima facie* e shtetësisë nuk mund të sigurohet nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara.

3. Nëse nuk mund të paraqitet asnjëri nga dokumentet e renditura në shtojcat 1 ose 2 të kësaj Marrëveshjeje, përfaqësuesit kompetent diplomatik ose konsullor të shtetit që i kërkohet, me kërkesë nga autoritetet kompetent të Shtetit Kërkues, do të bëjnë aranzhimet për të intervistuar personin që do të ri-pranohet pa vonesa të panevojshme dhe më së voni brenda pesë (5) ditëve të punës nga dita e kërkesës, në mënyrë që përcaktojnë shtetësinë e tij ose të saj.

4. Nëse është e nevojshme, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të dakordohen për një vizitë nga ekspertët e shtetit që i kërkohet me qëllim të intervistimit të personit në territorin e Shtetit Kërkues në mënyrë që të përcaktojnë shtetësinë e tij ose të saj. Shpenzimet e udhëtimit ose të qëndrimit të ekspertëve do të barten nga Shteti kërkues. Në rastet kur pas intervistës nga ekspertët, autoritetet kompetente mund të konfirmojnë ose në mënyrë të vlefshme të supozojnë se personi që do të ri-pranohet është shtetas i Palës Kontraktuese në fjalë, dokumenti i udhëtimit do të lëshohet menjëherë.

## **Neni 7**

### **Mjetet e dëshmisë në lidhje me shtetasit e vendeve të treta dhe personave pa shtetësi**

1. Dëshmitë mbi kushtet për ri-pranimin e shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje, do të sigurohen veçanërisht përmes mjeteve të dëshmisë të renditura në shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje. Ato nuk mund të sigurohen nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara. Çfarëdo dëshmie e tillë do të pranohet në mënyrë të ndërsjellë nga Palët Kontraktuese pa pasur nevojë për hetime të mëtejshme.

2. Dëshmitë *prima facie* të kushteve për ri-pranimin e shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje, në veçanti do të sigurohen përmes mjeteve të dëshmimit të renditura në shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje; dëshmia nuk mund të sigurohet përmes dokumenteve të falsifikuara. Kur



paraqitet dëshmia e tillë *prima facie*, Palët Kontraktuese do të konsiderojnë se janë përmbushur kushtet, përveç nëse mund të vërtetohet e kundërta.

3. Paligjshmëria e hyrjes në territorin e Shtetit Kërkues do të përcaktohet përmes dokumenteve të udhëtimit të personit në fjalë në të cilat mungon viza e nevojshme ose leje-qëndrimi për hyrje apo qëndrim në territorin e Shtetit Kërkues. Një deklaratë nga Shteti Kërkues që personi në fjalë është gjetur pa dokumentet e nevojshme të udhëtimit, vizë apo leje të qëndrimit do të paraqet gjithashtu dëshmi "*prima facie*" të hyrjes, apo qëndrimit të paligjshëm.

4. Dëshmitë e kushteve për ri-pranimin e ish-shtetasve të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ish- shtetas të ish – Republikës Federative të Jugosllavisë të përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje, në veçanti do të sigurohen përmes mjeteve të dëshmive të renditura në shtojcën 5a të kësaj Marrëveshjeje. Dëshmitë nuk mund të sigurohen nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara. Çfarëdo dëshmie e tillë do të pranohet në mënyrë të ndërsjellë nga Republika e Kosovës pa pasur nevojë për hetime të mëtejshme.

5. Dëshmitë *prima facie* të kushteve për ri-pranimin e shtetasve të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, ish- shtetas të ish – Republikës Federative të Jugosllavisë të përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje, në veçanti do të sigurohen përmes dokumenteve të renditura në shtojcën 5b të kësaj Marrëveshjeje. Dëshmitë nuk mund të sigurohen nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara. Kur paraqiten dëshmi të tilla *prima facie* Republika e Kosovës do të konsiderojë se janë përmbushur kushtet, përveç nëse vërtetohet e kundërta.

## **Neni 8**

### **Afatet kohore**

1. Aplikacioni për ri-pranim duhet të i dorëzohet autoritetit kompetent të shtetit që i kërkohet brenda një periudhe maksimale prej një (1) viti pasi që autoriteti kompetent i Shtetit Kërkues të ketë marrë informata se një shtetas i vendit të tretë ose person pa shtetësi nuk përmbush, ose nuk përmbush më tej kushtet e zbatueshme për hyrje apo qëndrim të ligjshëm.

Kur ekzistojnë pengesat ligjore ose faktike që kërkesa të dorëzohet me kohë, atëherë me kërkesë të Shtetit Kërkues, afati kohor do të zgjatet por vetëm derisa të mos ekzistojnë më pengesat.

2. Në të gjitha rastet, kërkesës për ri-pranim duhet të i jepet përgjigje me shkrim brenda njëzet (20) ditëve kalendarike. Ky afat kohor fillon të rrjedh nga data e pranimi të kërkesës për ri-pranim. Nëse brenda këtij afatit kohor nuk ka përgjigje, do të konsiderohet se është dakorduar për transferimin e personit.

3. Kur ekzistojnë pengesa ligjore ose faktike që kërkesës të i jepet përgjigja brenda njëzet (20) ditëve kalendarike, në bazë të një kërkesë të arsyetuar si duhet, ky afat kohor mund të zgjatet më së shumti deri në dyzet (40) ditë kalendarike. Nëse brenda këtij afatit kohor nuk ka përgjigje, do të konsiderohet se është dakorduar për transferimin e personit.

4. Arsytet për refuzimin e kërkesës për ri-pranim duhet të jepet me shkrim.

5. Pasi që është marrë pëlqimi, ose kur është e nevojshme, pas skadimit të afatit kohor të parashtruar në paragrafin 2 ose 3 të këtij neni, personi në fjalë do të transferohet brenda 3 muajsh. Me kërkesë të Shtetit Kërkues, ky afat kohor mund të zgjatet për aq kohë sa nevojitet që të tejkalohen pengesat ligjore apo praktike të transferimit.

## **Neni 9**

### **Modalitetet e transferimit dhe mënyrat e transportit**

1. Para kthimit të personit, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese në fjalë do të pajtohen paraprakisht dhe me shkrim në lidhje me datën e transferimit, pikën kufitare, përcjelljet e mundshme dhe informacione të tjera të rëndësishme për transferimin.

2. Aranzhimet e shkruara të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përmbajnë edhe informacionin e mëposhtëm shtesë:

- a) deklaratën që tregon se personi që duhet të kthehet mund të ketë nevojë për ndihmë apo përkujdesje, nëse kjo është në interes të personit në fjalë;
- b) çfarëdo mase tjetër mbrojtjeje apo sigurie, që mund të jetë e nevojshme në rastin individual të kthimit ose informata që kanë të bëjnë me shëndetin e personit, nëse është në interes të personit në fjalë.



3. Transportimi mund të bëhet përmes rrugëve ajrore apo tokësore. Kthimi përmes rrugës ajrore nuk do të kufizohet me përdorimin e vetëm transportuesve kombëtar të Palëve Kontraktuese dhe mund të bëhet duke përdorur fluturime të planifikuara (të rregullta) dhe fluturime charter (vajtje-ardhje).

#### **Neni 10**

#### **Ri-pranimi i gabuar**

1. Shteti kërkuar do të marrë prapa çdo person të ri-pranuar nga shteti që i është kërkuar nëse brenda një periudhe tre (3) mujore pas transferimit të personit në fjalë konstatohet që kushtet e parashtruara në nenet 2 apo në 3 të kësaj Marrëveshje nuk janë përmbushur.

2. Në raste të tilla, dispozitat procedurale të kësaj Marrëveshjeje do të aplikohen “*mutatis mutandis*” dhe do të sigurohen të gjitha informatat në dispozicion lidhur me identitetin dhe shtetësinë e personit që do të kthehet mbrapsht.

3. Në këtë rast, dokumentet origjinale në lidhje me personin duhet t'i kthehen autoriteteve kompetente të Shtetit Kërkuar.

### **PJESA III**

### **OPERACIONET TRANSITE**

#### **Neni 11**

#### **Parimet**

1. Palët Kontraktuese duhet të kufizojnë kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta apo të personave pa shtetësi vetëm me ato raste kur këta persona nuk mund të kthehen drejtpërdrejt në vendin e destinacionit.

2. Shteti prej të cilit kërkohet, do të lejojë kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta apo personave pa shtetësi nëse kjo kërkohet nga Shteti kërkues, nëse transportimi i mëtejshëm në shtetet e tjera të mundshme të transitit dhe ri-pranimi nga shteti i destinacionit është i garantuar.

3. Transiti mund të refuzohet nga autoritetet kompetente të palëve kontraktuese:

(a) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi është në rrezik real për t'iu nënshtruar torturës ose trajtimit jo-njerëzorë apo degradues apo dënimit me vdekje ose persekutimit për shkak të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të veçantë social apo bindjeve politike të tij në shtetin e destinacionit apo një shtet tjetër të transitit; ose

(b) nëse shtetasi i vendit të tretë ose personi pa shtetësi do t'iu nënshtrohet sanksioneve kriminale në shtetin e destinacionit përfundimtar ose në një shtet tjetër të transitit; ose

(c) në bazë të shëndetit publik, sigurisë së vendit, rendit publik apo interesave tjera kombëtare të shtetit që i kërkohet.

4. Palët Kontraktuese mund të anulojnë çfarëdo leje të dhënë nëse më vonë lindin ose dalin në dritë rrethanat e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni e të cilat bëhen pengesë për operacionet e transitit, ose nëse udhëtimi i mëtejshëm drejt shteteve të mundshme transite, ose ri-pranimi nga ana e shtetit të destinacionit nuk sigurohen më. Në këtë rast, shteti kërkues do ta marrë prapa shtetasin e vendit të tretë ose personin pa shtetësi, sipas nevojës dhe pa vonesë.

## **Neni 12**

### **Procedura e transitit**

1. Kërkesa për operacione transite duhet të i dorëzohet me shkrim autoritetit kompetent të shtetit që i kërkohet dhe duhet të përmbajné informatat në vijim:

(a) llojin e transitit (përmes rrugëve ajrore ose tokësore), shtetet e tjera të mundshme për transit dhe destinacionin përfundimtar të synuar;

(b) Të dhënat e personit në fjalë (p.sh. emrin, mbiemrin, mbiemrin e vajzërisë,



emrat tjerë të përdorur/me të cilat njihet ose nofken, datën e lindjes, gjininë dhe kur është e mundshme – vendin e lindjes, shtetësinë, llojin dhe numrin e dokumentit të udhëtimit);

(c) vendi i parashikuar i kalimit kufitar, koha e transferimit dhe përdorimi i mundshëm i shoqëruesve; nëse ka;

(d) deklaratën që përcakton se sipas mendimit të Shtetit Kërkues kushtet në pajtim me paragrafin 2 të nenit 11 të kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur, dhe se nuk ka ndonjë arsye për refuzim në pajtim me paragrafin 3 të nenit 11 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Shteti që i kërkohet brenda tri (3) ditëve të punës do të njoftojë me shkrim autoritetin kompetent të Shtetit Kërkues për pranimin, duke konfirmuar pikën e kalimit kufitar dhe kohën parashikuar të pranimit ose e informon për refuzimin e transitit dhe për arsyet e refuzimit të tillë.

3. Autoritetet kompetent të shtetit që i kërkohet pas konsultimeve reciproke, do të ndihmojnë në operacionet e transitit, në veçanti nëpërmjet mbikëqyrjes së personave në fjalë dhe sigurimit të pajisjeve të përshtatshme për këtë qëllim.

4. Nëse operacioni i transitit kryhet në rrugë ajrore, personi që do të ri-pranohet dhe shoqëruesit e mundshëm do të lirohen nga detyrimi që të pajisen me vizë transiti aeroportuale.

## **PJESA IV**

### **KOSTOT**

#### **Neni 13**

##### **Kostot e transportit dhe transitit**

1. Kostot që shkaktohen në lidhje me zbatimin e neneve 2 dhe 3 të kësaj Marrëveshjeje për transportin deri në kufirin e shtetit që i kërkohet, do të barten nga shteti kërkues në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi në territorin e shtetit përkatës.

2. Kostot që shkaktohen në lidhje me zbatimin e nenit 11 të kësaj Marrëveshjeje për transitin deri në kufirin e shtetit të destinacionit final do të barten nga shteti i kërkuar.

3. Kostot e transportit në lidhje me ripranimin e gabuar sipas nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje do të barten nga Shteti që i kërkohej.

## **PJESA V**

### **KLAUZOLA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE DHE MOS-NDIKIMI**

#### **Neni 14**

#### **Mbrojtja e të dhënave**

1. Transmetimi i të dhënave personale do të bëhet vetëm nëse një transmetim i tillë është i nevojshëm për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese dhe do të nënshtrohet legjislacionit kombëtar të Republikës së Kosovës dhe, kur kontrolluesi i të dhënave është autoriteti kompetent i Republikës së Lituanisë, sipas dispozitave të Rregullores (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Të dhënat personale, të dhëna në kërkesën për ri-pranim, do të përdoren vetëm për qëllime të zbatimit të procedurës së ri-pranimit siç përcaktohet në këtë Marrëveshjeje dhe nga autoritetet kompetente, përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Transmetimi i të dhënave personale tek institucionet e tjera të Palëve Kontraktuese mund të bëhet me pëlqimin paraprak me shkrim dhe autorizimin e qartë të Palës Kontraktuese e cila i ka transmetuar të dhënat personale dhe palët e treta marrëse angazhohen të respektojnë të njëjtat parime dhe masa mbrojtëse për mbrojtjen e të dhënave ashtu siç përcaktohet në këtë Marrëveshjeje. Autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese që ka transmetuar të dhënat personale, me kërkesën e tij, do të informohet për përdorimin e të dhënave të transmetuara dhe rezultatet e arritura.



2. Të dhënat personale duhet:

a) të përpunohen në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë;

b) të grumbullohen për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime në lidhje me procedurën e ri-pranimit dhe transitit dhe të mos përpunohen në mënyrë e cila nuk është në pajtim me qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje. Të dhënat personale të transferuara, kryesisht duhet të ndërlidhen si në vijim:

i. me të dhënat e personit që do të ri-pranohet ose personit që i nënshtrohet transitit ( p.sh. emri dhe mbiemri, emrat e mëparshëm, emrat e tjerë të përdorur/me të cilët njihet ose pseudonimet, gjinia, gjendja civile, data dhe vendi i lindjes, shtetësia aktuale dhe e mëparshme, fotografia e personit në fjalë, shenjat e gishtërinjve);

ii. me dokumentet e identifikimit, patentë shoferi ose dokumente të udhëtimit( numri, periudha e vlefshmërisë, data e lëshimit, autoriteti lëshues, vendi i lëshimit);

iii. me ndalesat dhe itineraret;

iv. me informacione të tjera të nevojshme për identifikimin e personit që do të ri-pranohet ose personit që i nënshtrohet transitit ose për të shqyrtuar nëse janë plotësuar kushtet për ri-pranim sipas kësaj Marrëveshjeje;

v. me rrethanat e veçanta që kanë të bëjnë me shëndetin e të transferuarit, duke përfshirë ndonjë tregues se ai ose ajo është një person i rrezikshëm, për qëllim të ofrimit të kujdesit shëndetësor ose trajtimit shëndetësor nën përgjegjësinë e një profesionisti i cili i nënshtrohet detyrimit të sekretit profesional.

c) të jenë të përshtatshme, relevante dhe të kufizuara për atë që është e nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat ato përpunohen;

d) të jenë të sakta dhe, kur është e nevojshme, të përditësuara. Duhet të merret çdo masë e arsyeshme për të siguruar që të dhënat personale të cilat nuk janë të sakta, duke pasur parasysh qëllimet për të cilat ato përpunohen, të fshihen ose korrigjohen pa vonesë. Kur bëhet e qartë se të dhënat personale të gabuara janë transmetuar ose të dhëna personale janë transferuar në mënyrë të paligjshme, autoriteti kompetent i njëjës prej Palëve Kontraktuese, me pranimin e të dhënave të tilla, do të njoftohet menjëherë për këtë dhe pa vonesë do ti korrigjojë, fshijë ose kufizojë përpunimin e tyre;

e) të mbahen në një formë e cila lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave

jo më gjatë se sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale;

f) të përpunohen dhe të transmetohen në mënyrën e cila garanton sigurinë e duhur të të dhënave personale, duke përfshirë mbrojtjen kundër përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe kundër humbjes, shkatërrimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masat e duhura teknike ose organizative për të siguruar një nivel sigurie të përshtatshëm për rrezikun; duke përfshirë, ndër të tjera, sipas rastit: pseudonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale; aftësinë për të siguruar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e vazhdueshme të sistemeve dhe shërbimeve të përpunimit; aftësinë për të rivendosur disponueshmërinë dhe qasjen në të dhënat personale në kohën e duhur në rast të një incidenti fizik ose teknik; procesin për testimin dhe vlerësimin e rregullt të efektivitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit.

3. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të sigurojnë që subjektet e të dhënave të kenë të drejtën të marrin qasje nga autoriteti kompetent për sa i përket përpunimit apo jo të të dhënave personale të tij/asaj dhe aty ku është rasti, qasje në të dhënat personale dhe informacionin për kategoritë e të dhënave personale në fjalë; marrësit ose kategoritë e marrësve të cilëve u janë dhënë ose do t'u zbulohen të dhënat personale; identitetin dhe të dhënat e kontaktit të autoriteteve kompetente; të dhënat e kontaktit të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave; qëllimet e përpunimit të të dhënave personale; të drejtën për të paraqitur një ankesë pranë një autoriteti mbikëqyrës dhe detajet e kontaktit të tij kur është e mundur, periudhën e parashikuar për të cilën do të ruhen të dhënat personale, ose, nëse nuk është e mundur, kriteret e përdorura për të përcaktuar atë periudhë; ekzistencën e së drejtës për të kërkuar nga autoriteti kompetent korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale ose kufizimin e përpunimit të të dhënave personale në lidhje me subjektin e të dhënave; kur të dhënat personale nuk janë mbledhura nga subjekti i të dhënave, çdo informacion i disponueshëm sa i përket burimit të tyre.

4. Me kërkesë të personit fizik, të dhënat e të cilit i janë transmetuar autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, ky person fizik jo më vonë se brenda një muaji pas marrjes së kërkesës nga autoriteti kompetent, do t'i jepet konfirmimi nëse të dhënat personale në lidhje me të janë duke u përpunuar apo jo, dhe, aty ku është rasti, qasja në të dhënat personale dhe informacionin se cilat të dhëna (kategoritë e tyre) janë transmetuar, qëllimin dhe bazën ligjore për përdorimin e tyre ose përdorimin e



synuar, marrësit (kategoritë e tyre) të cilëve u janë transmetuar të dhënat personale, periudha e parashikuar për të cilën do të ruhen të dhënat personale, ose, kur kjo nuk është e mundur, kriteret e përdorura për të përcaktuar atë periudhë, të drejtën për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale të subjektit të të dhënave ose kufizimin e përpunimit të tyre, të drejtën për të paraqitur një ankesë pranë një autoriteti mbikëqyrës dhe informacionin e kontaktit të tij. Autoriteti Kompetent i secilës Palë Kontraktuese mund të aplikojë një tarifë administrative ose të refuzojë të veprojë sipas kërkesës nëse kërkesat e subjektit të të dhënave janë të pabaza ose joproporcionale, veçanërisht për shkak të natyrës së tyre të përsëritur.

5. Një person fizik, të dhënat e të cilit janë transmetuar në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, do të ketë mundësinë të kërkojë plotësimin e të dhënave personale të tij/saj të cilat nuk janë të plota ose të dhënat personale të tij/saj të cilat nuk janë të sakta të korrigjohen, shkatërrohen si dhe të kërkojë kufizimin e përpunimit të të dhënave personale në rast se transmetimi i tyre shkel dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese duhet të informojnë autoritetin kompetent, nga i cili janë marrë të dhënat personale të pasakta, për korrigjimin e të dhënave të pasakta ose plotësimin e të dhënave personale jo të plota, si dhe për kufizimin e përpunimit të të dhënave personale për shkak të kërkesës së një person fizik. E drejta e një personi fizik në fjalë për të marrë një informacion të tillë rregullohet me legjislacionin në fuqi në territorin e shtetit të Palës Kontraktuese, në territorin e të cilit është paraqitur një kërkesë e tillë.

6. Kërkesa e një personi fizik në lidhje me zbatimin e të drejtave të tij/saj mund të refuzohet nëse një refuzim i tillë është i nevojshëm për të garantuar sigurinë publike dhe sigurinë kombëtare të Palës Kontraktuese, për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave kriminale ose ekzekutimin e dënimeve penale dhe gjithashtu për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjektit të të dhënave dhe personave të tjerë. Kërkesa e një personi fizik mund të refuzohet edhe nëse zbatimi i saj do të cenonte efektivitetin e veprimeve ose objektivave të ndjekura nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese. Arsyet dhe procedura e këtyre kufizimeve të të drejtave duhet të parashikohen në legjislacionin në fuqi në territoret e shteteve të Palëve Kontraktuese dhe motivet e këtyre refuzimeve do të dokumentohen si dhe do t'i jepet përgjigja subjektit të të dhënave.

7. Transmetimi, pranimi dhe fshirja ose kufizimi i të dhënave personale, si dhe refuzimi për transmetimin e të dhënave personale duhet të regjistrohen.

8. Transmetimi i të dhënave personale kërkon përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave të tilla, ashtu siç parashikohet në legjislacionin në fuqi në territoret e shteteve të Palëve Kontraktuese, pas skadimit të të cilave të dhënat personale të transmetuara duhet të shkatërrohen menjëherë. Në rast se të dhënat personale nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë transmetuar përpara afateve kohore të lartpërmendura, ose në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, këto të dhëna personale duhet të shkatërrohen menjëherë. Në këtë rast, autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese i cili i ka shkatërruar të dhënat personale do të njoftojë me shkrim Palën tjetër Kontraktuese. Palët Kontraktuese, menjëherë njoftojnë njëra-tjetrën nëse arsyeja për supozimin se të dhënat e transmetuara janë të pasakta, duhet të shkatërrohen ose është identifikuar humbja e të dhënave.

9. Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë që autoriteti kombëtar mbikëqyrës i mbrojtjes së të dhënave personale, duke vepruar në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi në territorin e Palëve Kontraktuese, kontrollon përputhjen me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale të parashikuara në këtë Marrëveshje. Në rast të shkeljes së të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, personat e prekur do të kenë të drejtën të bëjnë ankesë pranë autoritetit kombëtar mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave dhe të drejtën për qasje në drejtësi në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në territorin Palës Kontraktuese përkatëse.

10. Nëse autoriteti kompetent i njëres prej Palëve Kontraktuese është në dijeni për shkeljen e të dhënave personale, ai do të informojë autoritetin kompetent të Palës tjetër sa më shpejt të jetë e mundur dhe në koordinim me autoritetin kompetent të përmendur do të përdorë mjete të arsyeshme dhe të përshtatshme për të korrigjuar shkeljen e të dhënave personale dhe minimizimin e efekteve të mundshme negative.

## **Neni 15**

### **Klauzola e mos-ndikimit**

1. Kjo Marrëveshje nuk përjashton të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e secilës Palë Kontraktuese që në mënyrë të drejtpërdrejt ose indirekte dalin nga e Drejta Ndërkombëtare dhe në veçanti nga:



- (a) Konventa mbi Statusin e Refugjateve e datës 28 korrik 1951 e ndryshuar nga Protokolli mbi Statusin e Refugjateve i datës 31 janar 1967;
- (b) konventat ndërkombëtare që përcaktojnë Shtetin përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave të paraqitura për azil;
- (c) Konventa Evropiane e datës 4 nëntor 1950 për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
- (d) Konventa kundër Torturës dhe Dënimeve apo Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore, ose Degraduese e datës 10 dhjetor 1984;
- (e) konventat ndërkombëtare mbi ekstradimin dhe transitin;
- (f) konventat dhe marrëveshjet shumëpalëshe ndërkombëtare për ri-pranimin e shtetasve të huaj.

2. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk ndalon kthimin e personit sipas marrëveshjeve tjera formale.

## **PJESA VI ZBATIMI**

### **Neni 16**

#### **Bashkëpunimi dhe takimet e ekspertëve**

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të i ofrojnë njëra-terës asistencë të ndërsjellë në zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshje.

2. Palët Kontraktuese do të zgjidhin çfarëdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshje dhe/ose Protokollit për Zbatim nëpërmjet Komisionit të Ekspertëve, i cili do të përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese. Kur kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

3. Secila nga Palët Kontraktuese mund të kërkojë mbledhjen e Komisionit të Ekspertëve.



**Neni 17**  
**Protokollet për zbatim**

1. Ministria e Brendshme e Republikës së Lituanisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës do të përpilojnë protokolle për zbatim që do të përfshijnë rregullat mbi:

- (a) caktimin e autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese dhe pikat e kalimeve kufitare;
- (b) kushtet për kthimet me përcjellje të personave, përfshirë kalimin transit të shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi me përcjellje;
- (c) procedurën për intervista të paraparë në bazë të paragrafit 3 të nenit 6 të kësaj Marrëveshje;
- (d) formularin e përbashkët që do të përdoret për kërkesat për ri-pranim dhe transit.

**PJESA VII**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Neni 18**

**Shtojcat**

Shtojcat 1 deri në 6 të kësaj Marrëveshje, janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje.

## **Neni 19**

### **Njoftimet**

Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim për çfarëdo ndryshimi në lidhje me dokumentet dhe dëshmitë e renditura në Shtojcat 1-5 të kësaj Marrëveshje. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi që nga pranimi i njoftimit.

## **Neni 20**

### **Ndryshimet dhe plotësimet**

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet dhe plotësohet me shkrim përmes pëlqimit të ndërsjellë të Palëve Kontraktuese. Ndryshimet dhe plotësimet do të hartohen në formë të një protokolli të veçantë dhe do të përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshje. Protokolli do të hyjë në fuqi në të njëjtën mënyrë si kjo Marrëveshje.

## **Neni 21**


### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të ardhshëm nga dita e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike me anë të së cilit Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën mbi kompletimin e procedurave të brendshme të nevojshme që kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi.

2. Secila Palë Kontraktuese mund në çdo kohë të ndërpres këtë Marrëveshje duke i dhënë Palës tjetër një njoftim me shkrim përmes kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të përfundojë së zbatuari në ditën e nëntëdhjetë (90) pas datës së pranimi të njoftimit të tillë.

Nënshkruar në *Nju Jork*..... më *2024. 25 shtator*..... në dy kopje autentike, ku secila është në gjuhën Lituanëze, Shqipe, Serbe dhe Angleze, dhe të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve në interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje, teksti në gjuhën Angleze do të mbizotëroj.

**NË EMËR TË QEVERISË SË  
REPUBLIKËS SË LITUANISË**



**NË EMËR TË QEVERISË SË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**





Shtojca 1  
e Marrëveshjes ndërmjet  
Qeverisë së Republikës së Lituanisë dhe  
Qeverisë së Republikës së Kosovës për Ri-  
pranimin e Personave që Qëndrojnë pa  
Autorizim

**LISTA E DOKUMENTEVE  
PARAQITJA E TË CILAVE KONSIDEROHET SI DËSHMI PËR  
SHTETËSINË  
(Nenet 2 (1) dhe 6 (1) të Marrëveshjes)**

**Për Qeverinë e Republikës së Lituanisë:**

1. Pasaporta e një qytetari të Republikës së Lituanisë;
2. Pasaporta e Republikës së Lituanisë;
3. Karta personale e identitetit të Republikës së Lituanisë;
4. Pasaportë Diplomatike e Republikës së Lituanisë;
5. Pasaportë shërbimi e Republikës së Lituanisë;
6. Pasaportë e përkohshme e Republikës së Lituanisë.

**Për Qeverinë e Republikën e Kosovës:**

1. Certifikate valide e lindjes;
2. Certifikate e shtetësisë;
3. Letërnjoftim i vlefshëm;
4. Pasaporte e vlefshme.

Shtojca 2  
e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë  
së Republikës së Lituanisë dhe Qeverisë së  
Republikës së Kosovës për Ri-pranimin e  
Personave që Qëndrojnë pa Autorizim

**LISTA E DOKUMENTEVE  
PARAQITJA E TË CILAVE KONSIDEROHET SI DËSHMI *PRIMA FACIE*  
E  
SHTETËSISË  
(Nenet 2 (1) dhe 6 (2) të Marrëveshjes)**

**Për Republikën e Lituanisë**

1. Çdo kopje e dokumenteve të listuara në Aneksin 1 të Marrëveshjes;
2. Patentë shofer, të lëshuar nga autoriteti kompetent i Republikës së Lituanisë ose kopje të tyre;
3. Certifikata e lindjes ose kopje e tyre;
4. Kartelat e shërbimit, të lëshuara nga autoriteti kompetent i Republikës së Lituanisë ose kopje të tyre;
5. Deklaratat e dëshmitarëve;
6. Çdo dokument tjetër që mund të ndihmojë në përcaktimin e shtetësisë së personit në fjalë.

**Për Republikën e Kosovës**

1. Dokumentet e skaduar të renditura në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshje, apo fotokopjet e tyre;
2. Patente shoferi apo fotokopja e tij;
3. Certifikatat e lindjes (Për Republikën e Kosovës - të lëshuara nga UNMIK-u) apo fotokopjet e tyre;
4. Dokumentet e udhëtimit dhe/ose letërnjoftimet (Për Republikën e Kosovës - të lëshuara nga UNMIK-u) apo fotokopjet e tyre;

5. Libreza e Forcës së Sigurisë së Kosovës;
  6. Dokumentet ose letrat të cilat konfirmojnë anëtarësimin në forca të armatosura ose agjenci të shtetit për zbatim të ligjit;
  7. Deklaratat e dëshmitarëve;
  8. Deklaratat e dhëna me shkrim nga personi në fjalë;
  9. Të dhënat biometrike të personit, si shenjat e gishtërinjve, retina dhe irida e syrit, tiparet e zërit, vijat e fytyrës dhe të dhënat e matjeve të duarve;
  10. Rezultati i testit të ADN-së;
- Çfarëdo dokument tjetër i cili lëshohet nga autoritetet shtetërore që mund të ndihmoj në përcaktimin e shtetësisë së personit në fjalë.



Shtojca 3  
e Marrëveshjes ndërmjet  
Qeverisë së Republikës së Lituanisë dhe  
Qeverisë së Republikës së Kosovës për Ri-  
pranimin e Personave që Qëndrojnë pa  
Autorizim

**LISTA E DOKUMENTEVE  
TË CILAT KONSIDEROHEN SI DËSHMI TË KUSHTEVE PËR  
RIPRANIMIN E SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA  
SHTETËSI**

**(Nenet 3 (1) dhe 7 (1) të Marrëveshjes)**

1. Viza dhe/apo leje-qëndrimi i vlefshëm i lëshuar nga shteti që kërkohet;
2. Vulat e hyrjes/daljes apo të ngjashme të vendosura dokumentin e udhëtimit të personit në fjalë ose dëshmitë e tjera të hyrjes/daljes (p.sh., fotografi, video incizime);
3. Dokumente, certifikata dhe fatura të çfarëdo lloji (p.sh. fatura të hotelit, dokumentet për caktimin e terminit tek mjekët/dentistët, kartat e hyrjes në institucione publike/private, marrëveshjet për shfrytëzim të automjeteve me qira, faturat e kartës së kreditit, kartat e sigurimit shëndetësor, faturat e shërbimeve të përdorura, etj.), të cilat në mënyrë të qartë tregojnë se personi në fjalë ka qëndruar në territorin e Shtetit Kërkues;
4. Bileta me emër dhe/ose listat e pasagjerëve të udhëtimit përmes rrugëve ajrore, me tren, autobus apo me anije, të cilat tregojnë praninë dhe itinerarin e personit në fjalë në territorin e Shtetit Kërkues;
5. Informacioni që tregon se personi në fjalë ka përdorur shërbimet e një korrieri ose agjencie të udhëtimit;
6. — Deklaratat zyrtare të bëra veçanërisht nga stafi i autoritetit kufitar dhe dëshmitarët tjerë të cilët mund të dëshmojnë se personi në fjalë ka kaluar kufirin kombëtar;
7. Deklarata e personit që do të ri-pranohet e bërë tek autoritetet e Shtetit Kërkues e që është përfshirë në protokoll;
8. Deklaratat zyrtare nga personi në fjalë në procedurat gjyqësore apo administrative;
9. Deklaratat e përfaqësuesve të autoriteteve dhe personave tjerë.

Shtojca 4  
e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë  
së Republikës së Lituanisë dhe Qeverisë së  
Republikës së Kosovës për Ri-pranimin e  
Personave që Qëndrojnë pa Autorizim

**LISTA E PËRBASHKËT E DOKUMENTEVE TË CILAT  
KONSIDEROHEN SI DËSHMI *PRIMA FACIE* TË KUSHTEVE PËR  
RIPRANIMIN E SHTETASVE  
TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI  
(Nenet 3 (I) dhe 7 (2) të Marrëveshjes)**

1. Përshkrim i lëshuar nga autoritetet relevante të Shtetit Kërkues, sa i përket vendit dhe rrethanave sipas të cilave personi në fjalë është ndaluar pas hyrjes në territorin e atij shteti;
2. Informatat e ndërlidhura me identitetin dhe/apo qëndrimin e personit të cilat janë siguruar nga autoritetet ndërkombëtare apo organizata jo-qeveritare;
3. Raportet/konfirmimet e informatave nga ana e anëtarëve të familjes, bashkudhëtarëve etj;
4. Deklarata e personit në fjalë.



Shtojca 5  
e Marrëveshjes ndërmjet  
Qeverisë së Republikës së Lituanisë dhe  
Qeverisë së Republikës së Kosovës për Ri-  
pranimin e Personave që Qëndrojnë pa  
Autorizim

**LISTA E DOKUMENTEVE**  
**TË CILAT KONSIDEROHEN SI PROVA APO DËSHMI *PRIMA FACIE* TË**  
**KUSHTEVE PËR RIPRANIM TË SHITESAVE TË ISH-REPUBLIKËS**  
**SOCIALISTE FEDERALE TË JUGOSLLAVISË, ISH – REPUBLIKËS**  
**FEDERATIVE TË JUGOSLLAVISË**  
**(Nenet 3 (3), dhe 7 (4-5) të Marrëveshjes)**

**Shtojca 5a (dokumentet që konsiderohen si dëshmi nëse janë lëshuar para datës  
10 qershor 1999):**

1. Certifikatat e lindjes apo fotokopjet e tyre të lëshuara nga ish Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë, ish Republika Federative e Jugosllavisë;
2. Dokumentet publike apo fotokopjet e tyre të lëshuara nga Republika e Kosovës apo ish Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë, Ish Republika Federale e Jugosllavisë që përcaktojnë vendin e lindjes dhe/ose vendin e qëndrimit të përhershëm siç kërkohet me nenin 3(3).

**Shtojca 5b (dokumentet që konsiderohen si dëshmi prima facie nëse janë  
lëshuar para datës 10 qershor 1999):**

1. Dokumentet apo certifikatat e tjera apo fotokopjet e tyre e cila tregojnë vendin e lindjes në territorin e Republikës së Kosovës;
2. Deklarata zyrtare të personit në fjalë në procedurat juridike apo administrative;
3. Deklaratat e dëshmitarëve;
4. Deklaratat e dhëna me shkrim nga personi në fjalë.

Shtojca 6  
e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë  
së Republikës së Lituanisë dhe Qeverisë së  
Republikës së Kosovës për Ri-pranimin e  
Personave që Qëndrojnë pa Autorizim

**Festat Kombëtare të Republikës së Lituanisë**  
**(në bazë të Kodit të Punës të Republikës së Lituanisë)**

1. Festat Kombëtare:

- a) 1 Janar - Dita e Vitit të Ri;
- b) 16 Shkurt - Dita e Pavarësisë;
- c) 11 Mars – Rivendosja e Pavarësisë;
- d) Të Dielën dhe të të Hënën Pasuese të Lindores së Krishterë (sipas traditave perëndimore);
- e) 1 Maji – Dita Ndërkombëtare e Punës;
- f) Të Dielën e Parë të Majit – Dita e Nënës;
- g) Të Dielën e Parë të Qershorit – Dita e Babait;
- h) 24 Qershor – Dita e Shën Gjonit;
- i) 6 Korrik – Dita Kombëtare e kurorëzimit të Mindaugas, Mbretit të Lituanisë;
- j) 15 Gushti – Dita e Supozimit;
- k) 1 Nëntori – Dita e të Gjithë Shenjtorëve;
- l) 2 Nëntori – Dita e të Gjithë Shpirtrave;
- m) 24 Dhjetori – Nata e Krishtlindjes;
- n) 25-26 Dhjetori – Krishtlindjet.

**Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës**  
**(në bazë të Ligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës)**

1. Festat Zyrtare:

- a) Viti i Ri-1 dhe 2 janari;
- b) Krishtlindjet Ortodokse, 7 janar;
- c) Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, 17 Shkurti;

- d) Pashkët Katolike, E hëna e Pashkëve;
- e) Pashkët Ortodokse, E hëna e Pashkëve;
- f) Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 9 Prilli;
- g) Dita Ndërkombëtare e Punës, 1 Maji;
- h) Dita e Evropës, 9 Maji;
- i) Bajrami i Madh, dita e parë;
- j) Bajrami i Vogël, dita e parë;
- k) Krishtlindjet Katolike, 25 dhjetor.

2. Kur ditët e festave zyrtare të cekura në paragrafin 1 të këtij Aneksi bien ditën e shtunë ose të diel, ditë pushimi do të jenë ditët pasardhëse të punës.